



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:248412

Datë: 28.02.2023

Numri i dokumentit: 04027650

PPP.nr.73/2019

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh. A., me seli në Prishtinë Rr. “Nëna Terezë” nr. 36, kundër debitorit F.G. nga fshati..., komuna Skenderaj, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 1,536.86 euro, gjykata duke vendosur sipas prapësimit të parashtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e Përmbarimit P.nr.602/19 të datës 19.03.2019 të përmbaruesit privat Atip Mustafa, gjykata jashtë seancës, me datën 28.02.2023, bjen këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET prapësimi i debitorit F.G. nga fshati..., komuna Skenderaj, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.602/19 të dt.19.03.2019.

II. SHFUQIZOHET urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.602/19 i dt.19.03.2019 dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore abrogohen.

A r s y e t i m

Kreditori, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A., me seli në Prishtinë, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit Q.D., nga fshati..., komuna Skenderaj, për pagesën e borxhit në emër të energjisë elektrike të harxhuar për periudhën kohore dt.07.10.2006 e gjer me dt.20.03.2013, në shumë totale prej 1,536.86 euro, me kamat prej 8% vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajshme dhe të paluajshme e mjetet e mbledhura në shumën e kërkuar të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim të datës 18.03.2019.

Përmbaruesi privat A.M. nga Vushtrria, me Urdhrin përmbarior P.nr.602/19 të datës 19.03.2019, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori F.G. (djali i të ndjerit Q.D.) brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, në bazë të së cilit ka kundërshtuar lejimin e urdhrin përmbarimor me arsyetimin se me kreditorin kemi arritur marrëveshje për të përfituar në faljen e borxhit dhe ka qenë i obliguar që të paguaj vetëm shumën prej 409 euro me këste nga 22 euro për muaj dhe se borxhin me të cilin ngarkohem nga kreditori është paguar në tersi, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës për pagesën e borxhit është parashkruara sipas nenit 360 të LMD-së, ku kreditori e ka humbur të drejtën për ta kërkuar këtë borxh për shkak të parashkrimit, andaj kërkojmë nga gjykata që të aprovet prapësimi dhe të shfuqizohet Urdhëri përmbarimor, si dhe pezullohen të gjitha veprimet e ndërmarra nga përmbaruesi privat.

Kreditori në afatin e parashikuar ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, ku ka theksuar se pretendimet e debitorit se borxhi është i parashkruar, këto pretendime nuk qëndrojnë për faktin se propozimi për përmbarim është iniciuar në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit nga librat afarist duke u bazuar në nenin 29, 40 dhe 341 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Kreditori ka theksuar se ka kërkuar pagesën e tërësishme të borxhit për shkak se debitori është vonuar në pagesën e kështit sipas deklaratës mbi dakordimin e borxhit dhe në përputhje me nenin 3 të kësaj deklarate dhe nenin 10 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2015 për procedurat për faljen e borxheve publike, në rastet kur debitori shkakton 3 vonesa lidhur me pagesat sipas programit të pagesës, pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet, anaj pasiqë kundërshtimi i debitorit është i paargumentuar dhe i pabazuar i propozoj gjykatës që të mbetet në fuqi Urdhëri përmbarimor P.nr.602/19 i dt.19.03.2019.

Gjykata pas analizimit në shkresat e lëndës gjen se prapësimin e ka ushtruar F.G. - djali i debitorit - tani të ndjerë Q.D. dhe si dëshmi i ka bashkangjitur certifikatën e vdekjes në emrin e debitorit, ku konstatohet se ka vdekur me dt.20.05.2002, për çka gjykata duke marrë parasysh parimin e ekonomizimit të procedurës, si dhe duke marrë parasysh faktin se djali i tani të ndjerit disponon me pasurinë e të njëjtit, gjykata nuk veprohet konform nenit 35 par.4 të LPP-së në atë mënyrë që ta ndërpres procedurën deri sa të caktohen trashëgimtarët të cilët disponojnë me pasurinë e debitorit, andaj F.G. (djali i të ndjerit Q.D.) e ka marrë përsipër procedurën përmbarimore konform nenit 35 par. 6, i cili nën parashihet se “Pas mbarimit të bashkësisë trashëgimore, secili nga trashëgimtarët mund ta marrë përsipër procedurën përmbarimore duke iu paraqitur organit përmbarues”.

Gjykata në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se prapësimi është i bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohet përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Në bazë të Kontratës për pagesën e borxhit nr.56380 e dt.01.08.2017, Deklaratën mbi Dakordimin e Borxhit nr.5630 e dt.01.08.2017 të cilat gjendet ne shkresat e lëndës, e lidhur nga kreditori dhe debitori gjykata konstatoj se në këtë marrëveshje palët janë pajtuar që deri me dt.31.12.2008 obligimi i debitorit ndaj kreditorit është 1,303.53 euro, ndërsa për periudhën 01.01.2009-08.05.2013 obligimi i debitorit ndaj kreditorit është në shumën prej 409.33 euro për të cilin obligim janë pajtuar që të paguhet me këste mujore në shumë prej 22 euro dhe atë e ndarë në 18 këste (përfshirë kësti i fundit të paguhet në shumë prej 35.33 euro), me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve publike për periudhën deri me 31.12.2008.

Nga dokumenti i besueshëm – Ekstrakti nga librat afariste në bazë të të cilave është iniciuar procedura përbarimore, por edhe nga dëftesat e pagesave të dorëzuara nga debitori, gjegjësisht faturave nr.DMI17MC080146680/146 e dt.01.08.2017, fatura DMI17MC1002135645/258/258 e dt.03.10.2017, fatura DMI17MC120636493/16 e dt.06.12.2017, fatura DMI18MC011035645/106 e dt.11.01.2018, fatura DMI18MC0201155645/152 e dt.01.02.2018, fatura DMI18MC040936493/122 e dt.10.04.2018, fatura DMI18MC043035645/294 e dt.02.05.2018, fatura DMI19MC032746493/32 e dt.27.03.2019, fatura DMI19MC032746493/31 e dt.27.03.2019, fatura DMI19MC032746493/30 e dt.27.03.2019, fatura DMI19MC032746493/29 e dt.27.03.2019, fatura DMI19MC032746493/28 e dt.27.03.2019, fatura DMI19MC032746493/27 e dt.27.03.2019, fatura DMI19MC032746493/26 e dt.27.03.2019, fatura DMI19MC032746493/25 e dt.27.03.2019, fatura DMI19MC032746493/24 e dt.27.03.2019, fatura DMI19MC032746493/23 e dt.27.03.2019, në bazë të këtyre faturave dhe në bazë të transakcionit të konsumatorit në emrin e debitorit Q.D. i lëshuar nga KKFÉ-KESCO-KPSE, Distrikti Mitrovicë me dt.27.03.2019 debitori (në emër të pagesës së energjisë për KEK kësti) gjykata konsideron se debitori e ka përmbushur borxhin të cilin e ka pasur ndaj kreditorit për periudhën 01.01.2009 –08.05.2013 në shumën prej 409.33 euro.

Ndërsa për borxhin për periudhën 07.10.2006 – 31.12.2008 në shumë prej 1,303.53 euro, gjykata konsideron se kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit për shkak se ka kaluar afati 1 vjeçar brenda të cilit ka mundur të kërkohet pagesa, pasi që propozimi për përbarim është ushtruar me datën 18.03.2019, ndërsa në Kontratën dhe Deklaratën mbi Dakordimin e Borxhit Nr.56380 e datës 01.08.2017, kjo periudhe kohore nuk përfshihet si obligim i debitorit ndaj kreditorit.

Me qenë se në bazë provave në shkresat e lëndës, gjegjësisht faturave dhe transakcionit si dokument i besueshëm, konstatohet se debitori e ka përmbushur borxhin e dakorduar dhe pjesa tjetër e kërkesës së kreditorit është parashkruar, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e aprovuar prapësimin si të bazuar e rrjedhimisht duke shfuqizuar urdhrin përbarimor dhe duke i shfuqizuar të gjitha veprimet e ndërmarra përbarimore.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 22 par.1.1 dhe 23, 66, 69, 71, 73 par 3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, e në lidhje me nenin 360 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
PPP.nr.73/2019, me datë 28.02.2023

Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij Aktvendimit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.